UDHËZIM
Nr.17, datë 13.8.2007

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË INSPEKTORATIT NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR GJATË PERIUDHËS KALIMTARE TË TRANSFERIMIT TË PËRGJEGJËSIVE DHE DETYRAVE NË INSPEKTORATET NDËRTIMORE E URBANISTIKE VENDORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr.9000, datë 31.1.2003 "Për funksionimin dhe organizimin e Këshillit të Ministrave" dhe në ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit",

UDHËZOJ:

1. Në zbatim të nenit 17 pika 1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", Policia e Ndërtimit transformohet, me hyrjen në fuqi të ligjit, në Inspektorat Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar dhe ushtron si i tillë të gjitha përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në nenet 9 dhe 10 të ligjit në fjalë.
2. Në zbatim të nenit 17 pika 2 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", deri në miratimin e strukturës së re, me urdhër të Kryeministrit, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar do të funksionojë sipas strukturës së Policisë së Ndërtimit.
3. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar do të ketë vulën e tij të re, e cila do të ketë këtë paraqitje:

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekumunikacionit
Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar

4. Degët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar do të kenë vulën e tyre të re, e cila do të ketë këtë paraqitje:

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekumunikacionit
Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar

Dega Tirana-Qytet
Dega Tirana-Rreth
Dega Durrës
Dega Elbasan
Dega Lezhë
Dega Shkodër
Dega Gjirokastër
Dega Sarandë
Dega Kavajë
Dega Korçë
Dega Dibër
Dega Kukës
Dega Berat
Dega Fier
Dega Vlorë

5. Vula e kërkuar sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, do të jetë për përdorim të përhershëm nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.

6. Vulat e kërkuara sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, do të përdoret përkohësisht nga degët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar. Vula do të përdoret nga degët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar deri në transferimin e plotë të kompetencave të tyre në Inspektoratet Ndërtimore e Urbanistike të bashkive/komunave/qarqeve, pjesë përbërëse të territorit të kompetencave të tyre, në përputhje me nenin 17 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit".

7. Në zbatim të nenit 17 pika 2 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", deri në ngritjen e inspektorateve ndërtimore e urbanistike të bashkive/komunave/qarqeve, përgjegjësitë dhe detyrat e këtyre inspektorateve vendore të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" do të ushtrohen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar nëpërmjet degëve të tij.

8. Në zbatim të nenit 17 pika 2 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimi", titullari i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar do të emërtohet Drejtor i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar dhe kryetarët e degëve do të emërtohen (sipas strukturës ekzistuese) kryetarë të degës së Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, sipas degës përkatëse.

9. Përgjegjësitë dhe detyrat e Policisë së Ndërtimit të parashikuara në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" dhe në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", do të ushtrohen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar në përputhje me nenin 17 pika 2 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", deri në ngritjen e inspektorateve ndërtimore e urbanistike të bashkive/komunave/qarqeve.

10. Me ngritjen e Inspektorateve ndërtimore e urbanistike në nivel bashkie/komune/qarku, përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", nenet 4 dhe 5, transferohen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar në inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut të ngritur. Transferimi i përgjegjësive dhe detyrave do të bëhet që në ditën që Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar (ose dega e tij) ka marrë njoftim për ngritjen e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut përkatës.

11. Transferimi i praktikave dokumentare administrative, të cilat, në zbatim të ligjit "Për inspektimin e ndërtimit", hyjnë në fushën e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj për Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut që ngrihet, do të kryhet brenda një afati 10-ditor nga dita e marrjes së njoftimit të ngritjes së inspektoratit vendor.

12. Gjatë ushtrimit të përgjegjësive dhe detyrave në zbatim të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar dhe degët e tij do të nxjerrin akte administrative në përputhje me këtë ligj. Kundër vendimit të degës së Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, gjatë periudhës kalimtare, ushtrohet ankim administrativ pranë Drejtorit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.

13. Formularët e unifikuar të këtyre akteve administrative do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili do të unifikojë procedurën e ushtrimit të kontrollit në nivel vendor dhe kombëtar. Deri në miratimin e vendimit të sipërpërmendur, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar do të mbajë akte administrative sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKUMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR
DEGA_____

NR._____

VENDIM
PËR PRISHJEN E OBJEKTIT

Nr. ____, Datë_____

Në bazë të Proçes-Verbalit Nr._____datë_____ me nr.serie_____, të mbajtur nga inspektori/inspektorët i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar_____në subjektin juridik/fizik_____, ka rezultuar se është kryer kundravajtja_____
_____, parashikuar në nenin/et_____, e ligjit Nr._____, datë_____« Për_____»

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin/et _____,të ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007, « Për inspektimin e ndërtimit » dhe në nenin/et_____,e ligjit Nr._____datë _____« Për_____
_____

VENDOSA:

Dënimin për prishje të objektit_____
ndaj kundravajtësit_____
me adresë_____

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara nga në dispozitat ligjore në fuqi.

KRYETARI

(_____)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR
DEGA_____

NR._____

VENDIM
PËR PEZULLIMIN E PUNIMEVE NË NDËRTIM
Nr. ____, Datë_____

Në bazë të Proces-Verbalit Nr._____,Datë_____me nr.serie_____ të mbajtur në subjektin juridik/fizik_____, nga inspektori/ët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar_____
ka rezultuar se është kryer kundravajtja e mëposhtme:
1_____
_____
_____
_____
_____

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin/et _____,të ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007, « Për inspektimin e ndërtimit » dhe në nenin/et_____, të ligjit Nr._____datë _____« Për_____»

VENDOSA:

Pezullimin e punimeve të ndërtimit në objekt, për afatin 10 ditor, në përputhje me nenin 13 të ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 «Për inspektimin e ndërtimit», dhe në nenin/et_____të ligjit Nr._____"Për _____ »

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara nga në dispozitat ligjore në fuqi.

KRYETARI

(_____)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR
DEGA_____

NR._____

VENDIM
PËR DËNIM ME GJOBË

Nr. __, Datë _____

Në bazë të Proces-Verbalit Nr._____Datë_____me nr.serie_____ të mbajtur nga inspektori/ët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar_____ në subjektin juridik / fizik _____, ka rezultuar se është kryer kundravajtja_____ _____, parashikuar në nenin_____, ligji Nr._____, datë_____« Për_____»

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin/et _____,e ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007, « Për inspektimin e ndërtimit » dhe në nenin/et _____, të ligjit Nr._____datë _____« Për_____

VENDOSA:

Dënimin me gjobë në masën_____(_____) lekë kundravajtësin _____me adrese_____

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara nga në dispozitat ligjore në fuqi.

KRYETARI

(_____)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR
DEGA_____

Nr._____

PROÇES-VERBAL

I mbajtur me datë_____ nga inspektori/ët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar _____ në subjektin juridik/fizik_____,
me adresë_____ gjatë ushtrimit të kontrollit u konstatuan kundëravajtjet e më poshtme:

_____
_____
_____
_____
_____
_____

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 12, të ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007, «Për inspektimin e ndërtimit », u mbajt ky proçes-verbal dhe subjekti i kontrolluar_____
(pranon të nënshkruaj ___, nuk pranon të nënshkruaj ___, nuk i njihet identitetit ___)

Inspektorët

Subjekti i kontrolluar

1._____

2._____

3. _____